



Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës



“Ne jemi zëri juaj në Kuvend”

Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës është themeluar në korrik 2005.

Ky Grup përbëhet nga të gjitha gratë deputete në Kuvendin e Kosovës.

Grupi ka 36 anëtare dhe udhëhiqet nga Bordi i grupit që përbëhet nga një deputete prej secilit grup parlamentar, kurse kryesohet nga deputetja Dr. Flora Brovina.

Objektivat e grupit janë:

- Fuqizimi gruas në politikë dhe vendimmarrje;
- Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore si dhe të gjitha ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me përparimin e pozitës së gruas në shoqëri;
- Promovimi i mundësive të barabarta, në veçanti angazhimi për përmirësim të pozitës së gruas në edukim, shëndetësi, arsimim, kulturë, ekonomi etj;
- Zgjerimi i bashkëpunimit në mes të grave në politikë dhe shoqërisë civile;
- Bashkëpunimi në mes të grave deputete të parlamenteve regionale;
- Monitorimi i implementimit të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara;

Që nga themelimi, Grupi Joformal i Grave në Kuvendin e Kosovës ka ndërmarrë aktivitete të vazhdueshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes, kontaktit me qytetarë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Disa nga këto aktivitete përfshijnë:

- Nismën për hartimin e Ligjit për Barazi Gjinore;
- Nismën për ndryshimin e ligjeve me interes të veçantë për gratë dhe fëmijët;
- Organizimin e dëgjimeve të ndryshme publike, tryezave të rrumbullakta me ekspert të ndryshëm si dhe organizimin e konferencave rajonale të grave deputete nga vendet fqinje;
- Vizita në shkolla të mesme dhe takime me qytetarë;
- Pjesëmarrja në debate mediale me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut për çështje të ndryshme si arsimimi, shëndetësia, dalja e femrave në zgjedhje, rëndësia e kyçjes së femrës në ekonomi, etj;
- Takime me gratë kryefamiljare në pjesë të ndryshme të Kosovës si dhe vizita në strehimore kolektive për gratë e keqtrajtuara.
- Takime nëpër komuna me këshilltarë komunalë;
- Takime të rregullta me shoqërinë civile dhe agjensionet qeveritare;

Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës është nënshkrues i Memorandumit Ndërkombëtar për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Grupi poashtu angazhohet fuqishëm në luftë kundër kancerit të gjirit.

Rekomandimet e grupit joformal të grave:

- Rezoluta e KB 1325 të jetë pjesë e Kushtetutës së Kosovës;
- Demokratizimi i brendshëm i partive politike dhe kuota prej 30% me qëllim të fuqizimit të femrës;
- Kori diplomatik si dhe përfaqësitë jashtë vendit të kenë pjesëmarrje adekuate të femrave;
- Përfaqësimi i femrave në organet ekzekutive në nivelin qendror dhe atë lokal të përcjellë trendin e kuotës prej së paku 30%;
- Formimi i lobit të grave të parlamenteve regjionale.

Nëse dëshironi të merrni ndonjë informatë, të merrni ndonjë këshillë, të jepni sygjerime në lidhje me punën dhe aktivitetin tonë, si dhe të ngritni çështjet me interes për ju – ju lutem të na drejtoheni në kontaktet e poshtë shënuara.

Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës ju mirëpret.

* * *

Informacionet për kontakt:

Kuvendi i Kosovës, zyra N-319/a

Bulevardi Nëna Terezë p.n.

1000 Prishtinë/Kosovë

Tel: 038 200 10 438

038 211 330

e-mail:

woman.caucus@ks-gov.net

womancaucus@gmail.com